

# VULLNETI I POPULLIT



# THEMEL I DEMOKRACISË

## DEMOKRACIA DHE QYTETARËT

MERITON (12), ARLIND (12), SARA (12), RONI (12), BAJRAM (12), VILSON (12), AGNESA (12),  
ENES (12), RINESA (12)



**Shumë të dashur bashkëmoshatarë, sot grupi ynë ka diskutuar gjerë e gjatë për demokracinë dhe rëndësinë e saj. Po ashtu, kemi diskutuar edhe për qytetarinë aktive. Por, se si e kemi bërë lidhjen në mes këtyre dy temave, iu ftojme të lexoni artikullin tonë. E kemi shkruar me shumë dashuri për ju**

Fjala demokraci është fjala më e dashur për të gjithë ne qytetarët. E dijmë shumë mirë që demokracia në vete ngërthen lirinë dhe shumë elemente të tjera. Por, më qenësorja për ne është liria. Pse liria? Sepse si qenie njerëzore meritojmë të jemi të lirë. Ne meritojmë të jetojmë jetën në mënyrën më të mirë të mundshme, meritojmë dhe duhet të trajtohem gjithmonë për atë që jemi. E kur ka liri, ne mund të lulëzojmë porsia lulëzon lulja kur ujitet. Për ne, liria është si vitaminat që mbajnë trupin e njeriut. Ajo është pjesë kyçe e demokracisë. Por, a e dini ju se pse demokracia është kaq e rëndësishme? Demokracia na mundëson të jemi të lirë dhe aty ne mund t'i shprehim lirshëm mendimet tona. Falë saj, ne, qytetarët, jemi të lirë të vendosim vetë për të ardhmen tonë. Kjo mundësohet prej të drejtave të shumta që qytetarët i kanë në demokraci. Jemi duke e përmendur shumë demokracinë, por ende nuk iu treguam se nga rrjedh kjo fjalë kaq e ëmbël. Fjala demokraci është dëgjuar për herë të parë në kryeqytetin e Greqisë, në Athinë (në shekullin V-të, para erës sonë). Pasi që jemi tek shekulli i V-të para erës sonë, dëshirojmë t'iu tregojmë që demokracia në atë kohë nuk ka qenë e zhvilluar, ashtu siç është sot. Asokohe, ka pasur padrejtësi, duke përfshirë këtu diskriminimet që ua janë bërë qytetarëve të cilët kanë qenë të varfër, në krahasim me feudalët. Gratë nuk janë konsideruar në mënyrë të barabartë, sepse gjithmonë janë trajtuar si skllave. Edhe përtej Greqisë kishte diskriminime, si p.sh.: afro-amerikanët nuk janë trajtuar në mënyrë të

barabartë me njerëzit e racës së bardhë. Me zhvillimin e demokracisë, njerëzit kanë filluar të vetëdijësohen për të drejtat e tyre dhe kanë filluar t'i kërkojnë ato. Gratë, tani e kanë të drejtën e tyre të votimit, të shkolimit, të pronës, etj. Por, a është shteti ynë demokratik? Po, sepse pas sundimeve të njëpasnjëshme, populli ynë ka filluar procesin e tij për demokratizim. Tani të gjithë qytetarët e Kosovës gëzojnë të drejtat e tyre dhe kanë të drejtën e shprehjes, të mendimit dhe të bashkëpunimit ndërmjet vete. Mirëpo, çka e bën shtetin tonë demokratik? Shtetin tonë demokratik përpos këtyre që i cekëm më lart, e bën po ashtu edhe e drejta e votimit, e drejta për vendimmarrje, e shumë e shumë të drejta të tjera. Siç po e shihni edhe ju, demokracia nuk qenka diçka e thjeshtë. Andaj, kërkon kujdes dhe dashuri prej secilit prej nesh. Ne jemi ata që duhet ta mbrojmë dhe të punojmë në mënyrë që ajo të zhvillohet më së miri.



Gazetarët e artikullit

**Në artikullin e parë shokët dhe shoqet e mia iu kanë dhënë më shumë informata rreth demokracisë dhe zhvillimit të saj. Ndërsa, në këtë artikull, unë Agnesa dhe Meritoni do t'iu informojmë më shumë për qytetarinë aktive, sepse është e rëndësishme ta dijmë si si mund të jenë aktiv qytetarët e moshës sonë**

Për të qenë qytetarë aktiv, ne duhet të ndërmarrim iniciativa të ndryshme me grupe qytetarësh vullnetarë. P.sh. disa nga iniciativat që ne i kemi marrë si nxënës vullnetar janë: mbjellja e bimëve, pastrimi nga brenda i shkollës, pastrimi i oborrit, po ashtu dhe reciklimi i shisheve të plastikës.

Për të përhapur iniciativat që i bëjmë duhet përdorur fletëpalosjet. Së pari bëjmë zgjedhjen e udhëheqësit të grupit, pastaj përgatitet posteri i cili përdoret për reklamimin e iniciativës që e marrim ne si qytetarë aktiv. Posterat duhet vendosur në vende ku tërhiqet vëmendja e qytetarëve. Këto iniciativa të qytetarëve ndikojnë pozitivisht në vendin tonë.

Por, kemi edhe iniciativa të cilët mund t'i bëjmë si në

nivel komunal, ashtu dhe në nivel kombëtar. Për iniciativat kombëtare duhet bërë diçka sa më të mirë për vendin tonë. Këtë e arrijmë duke marrë iniciativa të reciklimit të materialeve plastike, duke e rritur kështu buxhetin familjar dhe duke zhvilluar ekonominë e vendit. Qytetaria aktive është një term shumë i gjerë, por qëllimi i saj është shumë i thjeshtë: zhvillimi i vendit, dhe e ardhme më e mirë për brezat e tanishëm dhe për brezat e ardhshëm. Qytetarët aktiv kur bëjnë punë aktive, nuk e pasurojnë vetëm lagjen apo vendin ku ata/ato aktivizohen. Ata/ato, po ashtu, pasurojnë edhe vetveten e tyre, sepse e mbushin zemrën me mirësi. Por, po ashtu edhe trurin me dije dhe përvojë të re. Aktivizimi është pjesë e demokracisë.

**Në vizatimet që i kanë përgatitur shokët dhe shoqet tona, jemi munduar t'iu tregojmë se si mund të jemi ne fëmijët aktiv. Po ashtu, kemi paraqitur edhe të drejtën e shkollimit që të gjithë qytetarët e Kosovës e gëzojnë**



Në vizatimin e parë kemi paraqitur disa nxënës, të cilët kanë marrë iniciativë për të pastruar komunitetin e tyre. Pasi ata përfunduan punën, shkuan në shtëpi, shfletuan librat dhe mësuan se si mund të jenë aktiv edhe jashtë komunitetit të tyre




Pasi mësuan se aktivizimi i tyre mund të ketë ndikim shumë të madh dhe pozitiv për të gjithë shoqërinë, ata u mbledhën dhe festuan për kontributin që kishin dhënë vendit të tyre. Qytetarët aktiv mendojnë për të gjithë, jo vetëm për vetveten

## ZGJEDH ME MENÇURI, JETO PLOT LUMTURI

BESNIK (13), VALON (12), ADEA (12), ARITA (13), ARTA (12), MALDA (12), ERON (12), DION (12),

JON (12)



Përfaqësuesit e popullit zgjedhen me votim të mbyllur



Në jetën e përditshme shumë herë përdorim votimin e hapur

### Edhe pse jemi të vegjël, mendimet tona vlerësohen dhe merren parasysh, sepse ne jemi e ardhmja e vendit

Shumë herë në jetën tonë kemi mundësinë të zgjedhim atë që dëshirojmë. E bardhë apo e kuqe? Ishin këto dy ngjyra në mes të cilave duhej të zgjedhnin nxënësit e klasës VII-4 për bluzat e tyre që do t'i vishnin në garat komunale në lëndën e gjuhës gjermane.

Mirëpo, jo të gjithë e kishin mendimin e njëjtë për ngjyrën që e pëlqenin. Kështu, ata vendosën që ngjyrën e bluzës ta zgjedhnin me anë të votimit të hapur. Së pari, u vendos në votim ngjyra e kuqe, e pastaj u vendos e bardha. Nga 29 nxënës, 17 prej tyre e votuan ngjyrën e kuqe, kurse 12 prej tyre të bardhën. Natyrisht që u vendos për ngjyrën e kuqe, ngaqë kishte më shumë vota sesa e bardha. Nga kjo mund të themi se çdo herë fiton shumica.

Nxënësit e shkollës fillore të mesme të ulët „Abdullah Shabani“ kishin mundësinë të zgjedhnin një lëndë, të cilën do ta mbanin në mënyrë vullnetare. Mirëpo, zgjedhjen e kësaj lëndë nuk mund ta bënin me votim të hapur, për shkak të numrit të madh të nxënësve. Kështu që, duhej të krijonin një listë në të cilën paraqiten lëndët, nga mesi i të cilave duhej të zgjedhej vetëm një. Nxënësit kishin mundësi të zgjedhnin njëren nga këto lëndë: gjuhë shqipe, fizikë,

edukatë qytetare apo matematikë. Pasi që përfundoi votimi, filloi edhe numërimi i votave. Sipas numërimit të votave 23% ishin për gjuhë shqipe, 7% për fizikë, 20% për edukatë qytetare dhe 50% për matematikë. Pra, si lëndë u vendos lëndë e matematikës, sepse kishte përqindjen më të madhe të votave.

E gjithë kjo përcjell një mesazh që e di, pothuajse, secili prej nesh. Edhe pse kemi mendime dhe preferenca të ndryshme, pra ekziston një diversitet i mendimeve, në zgjedhjet demokratike fiton shumica.

Jemi ne ata që zgjedhim për veten tonë. Jemi ne ata që jemi të lirë të shprehim mendimet tona.

Prandaj, ne si fëmijë, jetojmë të lumtur në vendin tonë demokratik.




Grupi „E ardhmja“

**Ligjet, rregulla të cilat duhet të respektohen dhe të zbatohen nga të gjithë qytetarët. Bëhuni edhe ju si ne, zbatoni rregullat, zbatoni ligjet**

Ne mendojmë dhe besojmë se askush nga ne nuk ka dëshirë të jetoj një jetë me plot kaos rreth vetes. Secilit prej nesh i duhet një jetë e qetë dhe me rregull. Mënyra e vetme për ta larguar kaosin është zbatimi i ligjit. Ligji është sikur stina e pranverës. Është një kohë që lulëzon e sjell një ndjenjë paqësore. Mirëpo, ne vetë qytetarët me mosrespektimin e tij, bëhemi sikur një vetëtimë dhe erë e fortë e cila e prish lulëzimin dhe shkatërron çdo gjë që shfaqet rreth saj. Ndonjëherë themi se vendi më i qetë dhe më i sigurt është shtëpia. Le ta mendojmë njëherë se si do të ishte të ndjehemi të sigurt edhe kur nuk jemi në shtëpi. Respektimi i ligjit është pikërisht ai që na bën të ndjehemi të sigurt. Nëse dëshirojmë që çdo njeri të respektoj ligjet, ne duhet të bëhemi shembull për ta. Prandaj, bëhu qytetar i ndershëm, respekto ligjin, lulëzo jetën.



Thuaj stop shkeljes së ligjit



Shkolla, vendi i diturisë



Të drejtat tona si fëmijë i kemi të garantuara me ligj



Qytetarët e përgjegjshëm respektojnë njëri-tjetrin



Vepro me kohë për një të ardhme më të mirë

## KONTROLLI DHE BALANCA

OLT (12), SAIMIR (13), ISMAIL (12), AGNESA (12), ARIANIT (12), ALTUNA (12), RUMEJSA (12),

SHEREMET (12), RION (12)



**A keni kapur ndonjëherë Kushtetutën e Kosovës në duar dhe a e keni lexuar një ndër nenet më të rëndësishme, siç është Neni 4? Nëse jo, do ta kuptoni tani se çfarë thotë ky nen**

Kur arritëm në Punëtorinë e Demokracisë ne e dinim se çfarë është Kushtetuta, por nuk e kishim prekur me dorë atë. Sof, kemi hasur në Kushtetutën e Kosovës, pikërisht në këtë Punëtori. Neni për të cilin po flasim është Neni 4 dhe sot patëm mundësinë ta lexojmë me shumë vëmendje. Ai thotë: „Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit të tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë.“ Çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë se në vendet demokratike ekziston ndarja e pushtetit. Por, kush e ka pushtetin në një vend demokratik? Pushtetin në demokraci e mban populli. Këtë pushtet, populli ua huazon përkohësisht disa institucioneve. Kjo bartje e pushtetit ndodh përmes

procesit të zgjedhjeve, ku qytetarët mbi moshën 18 vjeçare, kanë të drejtën e votës. Nga votat tona, kandidatët marrin pushtetin tonë, të cilin duhet ta ndajnë në mes vete. Përse ndodh kjo? Kjo ndarje ndodh për shkak se kur ndahen punët, ato bëhen më lehtë edhe më shpejt. Nëse vetëm njëri prej nesh do të punonte, atëherë vetëm ai do të kishte pushtet. Marrim shembull grupin tonë. Ne e dijme se secili nga ne duhet të



**Olti duke lexuar Nenin 4 të Kushtetutës**

punojë diçka, por Altuna tha se ajo dëshiron të bëjë të gjitha punët vetëm. Grupi pa u menduar dy herë pranoi. Pasi përfunduan punët dhe erdhi koha e drekës, Altuna tha: „Unë do të ha të gjithë ushqimin, sepse vetëm unë punova.“ Grupi i çuditur nga fjalët e Altunës tha: „ Kjo nuk është e drejtë. Edhe ne duhej të të kishim ndihmuar.“ E kuptoni tash se sa e rëndësishme është që të gjithë të japim kontributin tonë?




**Buzëqeshja jonë kur hasëm në Kushtetutë**

**Fillimisht dëshirojmë t'iu tregojmë se historia që e kemi shkruar paraprakisht nuk është e vërtetë. Ajo është vetëm një ilustrim për juve lexues që ta kuptoni më mirë temën e ndarjes së pushtetit. Më poshtë do të lexoni për tri degët e pushtetit**

Pushteti në Kosovë ndahet në tri degë të rëndësishme: dega Legjislative, Ekzekutive dhe dega Gjyqësore. Dega Legjislative përfaqësohet nga Kuvendi. Kuvendi është organ legjislativ. Nga e ka marrë këtë emër? Këtë e ka marrë nga detyra e tij kryesore që është krijimi dhe miratimi i ligjeve. E ç'janë ligjet? Ligjet janë rregulla të cilat duhet të zbatohen nga të gjithë. Ndërsa, Kuvendi është vend ku deputetët bisedojnë për të ardhmen e Kosovës. Gjithsej në Kuvendin e Kosovës punojnë 120 deputetë, të cilët votohen çdo 4 vjet. Këta deputetë duhet t'i plotësojnë të gjitha premtimet e dhëna gjatë fushatës zgjedhore.

Artikullin e vazhdojmë duke folur pak për degën Ekzekutive. Ajo përfaqësohet nga një organ shumë i lartë që është Qeveria. Aty punojnë Kryeministri dhe ministrat e tjerë, të cilët zgjedhen me votat e deputetëve të Kuvendit, po ashtu, çdo 4 vjet. Qeveria quhet institucion


ekzekutiv, sepse ka për detyrë të bëjë ekzekutimin ose zbatimin e ligjeve e miratuara nga Kuvendi. Këtë detyrë, Qeveria e realizon përmes ministrive të saj, si: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Bujqësisë, etj. Ministrinë janë pjesë e Qeverisë dhe secila nga to ka rolet dhe detyrat e veta. Dega e tretë, por jo më pak e rëndësishme është dega e Gjyqësorit. Ajo është një degë e rëndësishme, e cila përfaqësohet nga gjykata. Në gjykatë marrin pjesë: prokurori, avokati apo mbrojtësi ligjor, i dyshuari, dëshmitari, publiku, etj. Gjykata Themelore, ajo e Apelit dhe Gjykata Supreme, janë gjykatat në Kosovë. Të gjitha këto gjykata vendosin drejtësi dhe rregull në vend, duke u bazuar në Kushtetutën e Kosovës. Neve na pëlqeu shumë kjo temë dhe na u duk shumë interesante. Ashtu si funksionojnë institucionet në harmoni mes vete, ashtu edhe ne sot funksionuam në grupin tonë.



Një punim yni për Gjykatën



Gazetarët e rinjë nga Mitrovica



Tri institucionet kryesore në demokraci



Kuvendi, Qeveria dhe Gjykata



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Abdullah Shabani“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VII-4  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Mitrovicë